

VENDIM
Nr. 62, datë 6.9.2018

PËR LICENCIMIN E UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA SARANDË

(Ndryshuar me vendimin nr. 86, datë 4.3.2021)

(I përditësuar)

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë për licencim për efekt të përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë, me NUIS: J64228814D, është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 40, datë 11.12.2013, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-kanalizime Sarandë”, e vlefshme deri në datën 13.6.2016.

- Shoqëria, me shkresën nr. 364 prot., të datës 11.7.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës. Me shkresën nr. prot. 375, datë 26.7.2018, janë bërë plotësimet përkatëse në dosjen e aplikimit pas mangësive që kishte.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë ofron shërbim edhe në disa fshatra të Bashkisë Finiq deri në përfundim të kalimit faktik të aseteve.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë detyrohet të njoftojë ERRU-në, pasi të ketë përfunduar procesin e kalimit faktik të aseteve të Bashkisë Finiq.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë, me:

Drejtues ligjor: Sheme Lulo;

Drejtuesit teknik: Eljon Mahmutaj.

2. Operatori Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë sh.a. është Bashkia Sarandë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

